

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJILAN/** Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, ne çështjen penale ndaj të akuzuarit F.S. nga fshati ... K. ... të cilin me autorizim e përfaqëson avokati E.Q. nga ..., për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.Nr.1005/2016 të datës 16.06.2016, të cilin e përfaqëson prokurorja Bahtije Ademi, pas mbajtjes të shqyrtimit gjyqësor më datë 20.06.2018, mori dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I Pandehuri **F.S.**, nga i ati **Q.**, e ëma **S.**, e lindur **H.**, i lindur më dt. ... në ... me vendbanim në fshatin ... ku edhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pa martuar i gjendjes ekonomike të mesme, shqiptar shtetas i R Kosovës edhe më parë i dënuar për vepra të njëjta penale, dhe udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

### Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, më datë 13.05.2016, ndërmjet fshatit ... dhe ..., i pandehuri F.S., së bashku me të miturin E.S me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror për vete apo për personin tjetër, ka vjedhur në dëm të dëmtuarit I.Sh. nga fshati. ..., në atë mënyrë që së bashku me të miturin E.S shkojnë te shtëpia e të dëmtuarit ku i pandehuri F. fillimisht e shtynë derën e hyrjes së shtëpisë, me bërriyl të dorës, por pasi që dera nuk hapet, pastaj i mituri E.S e godet me shqelm, e hapin me forcë, depërtojnë brenda shtëpisë, e dëmtojnë edhe derën e banjës vjedhin një shishe viski (pije alkoolike) pastaj largohen e thyejnë shishen, dhe në këtë mënyrë të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë rreth 1000 euro.

-me çka ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafi 1,1 lidhur me nenin 31 të KPRK.

Prandaj gjykata duke ju referuar marrëveshjes së arritur me shkrim mbi pranimin e fajësisë të akuzuarit F.S., në bazë të dispozitës ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 46, 50, 51, 73,74,75 si dhe neneve 233 dhe 365 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të akuzuarin e shqipton:

### E G J Y K O N

Të pandehurit F.S., i shqiptohet dënim kumulativ me burg në kohëzgjatje prej 2 vite e 9 muaj (dy vite e nëntë muaj) dënim i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 2 (dy) viteve nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale,

dhe dënimi me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro), të cilin dënim do ta paguaj në tre këste të barabarta mujore ashtu që këstin e parë prej 100 euro do ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa këstin e dytë dhe të tretë prej nga 100 euro do ta paguaj në fillim të muajve vijues dhe atë deri me datën 05.

Nëse i pandehuri refuzon që të paguajnë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguajë atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurin mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimin me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimin me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20.00 € (njëzetë euro) në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm. Të akuzuarit i shqiptohet taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej 30.00 € (tridhjetë euro), në bazë të nenit 39 paragrafi 3, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

## **ARSYETIM**

### 1. Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, më datë 16.06.2016 ka ngritur aktakuzën e lartcekur, ndaj të akuzuarit F.S., për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-s. Po ashtu me datën 08.06.2018, në këtë gjykatë është dorëzuar edhe një marrëveshje për pranimin e fajësisë lidhur në mes Prokurorisë Themelore në Gjiilan/Departamenti i përgjithshëm në njërën anë dhe në anën tjetër të pandehurit F.S., me mbrojtësin e tij me autorizim av. E.Q. nga .... Sipas kësaj marrëveshje, kësaj Gjykate i është rekomanduar, që ndaj të akuzuarit F.S., për shkak të veprës penale, ti shqiptohet dënim kumulativ me gjobë dhe me kusht.

### 2. Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datë 20.06.2018, gjykata pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit, ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari dhe pas konsultimit të mjaftueshme me mbrojtësin e tij avokat E.Q., se i akuzuari nuk ka qenë në asnjë mënyrë i detyruar apo i shtrënguar në asnjë mënyrë të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi 1 të KPP-s.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj vepre, ekziston fakti se i akuzuari F.S. ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafi 1,1 lidhur me nenin 31 të KPRK-s, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve dhe të mbrojtësit lidhur me dënimin, e ka shpallur fajtor të akuzuarin F.S., për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafi 1,1 lidhur me nenin 31 të KPRK-s. Ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i njëjti siç e ka pranuar edhe vet.

Në nenin 327 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-s, Vjedhje e rëndë konsiderohet:

1. Kushdo që kryen vjedhje nga paragrafi 1. i nenit 325 të këtij Kodi, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet, nëse:

1.1. vepra është kryer duke thyer, kaluar apo depërtuar me forcë në veturat e mbyllura, ndërtesat, dhomat, arkat, sanduqet apo hapësirat tjera të mbyllura ose duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme;

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se duhet të pranohet rekomandimi i paraqitur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, që të akuzuarit F.S. ti shqiptohet kumulativ me gjobë dhe me kusht, ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën, janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë një dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit e të akuzuarit, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 73 dhe 76 të KPRK-s, Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka zbutur dënimin dhe ndaj të akuzuarit ka shqiptuar dënim nën minimumin e posaçëm, është fakti se i akuzuari ka arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Gjilan / Departamenti i përgjithshëm. Gjithashtu, si rrethana posaçërisht lehtësuese, gjykata ka marrë dhe faktin se i akuzuari ka bashkëpunuar me prokurorin e shtetit, se pranimin e fajësisë e ka bërë në të gjitha fazat e procedurës penale, se i akuzuari është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, e se i njëjti ka premtuar se nuk do të kryej vepra tjera penale, sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar dhe gjyqësor si. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i akuzuarit me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale. Ndërsa, rrethanë rënduese është se vepra penale është kryer me dashje dhe dëmi i shkaktuar të dëmtuarit.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata, ka konstatuar se me dënim me gjobë dhe me kusht, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest juridiko civil.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar në nenin 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor, si dhe taksa për Kompensimin e Viktimave në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

**Departamenti i Përgjithshëm**

**P.nr. 754/2016-Më 20.06.2018**

**Sekretarja juridike,**  
Igballe Azemi d.v

**Gjyqtari,**  
Behar Ymeri d.v

**KËSHILLA JURIDIKE** : Ky aktgjykim është i formës së prerë, ditën e shpalljes së aktgjykimit në pajtim me nenin 233 par.12 pika 1, dhe pika 3. të KPPRK-s.

